



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:080794
Datë: 10.08.2022
Numri i dokumentit: 03314284

C.nr.442/19

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti Përgjithshëm gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.K., F.K., dhe Z.K., që të gjithë nga fshati, komuna e Prizrenit, të cilët me aktpërfaqësim i përfaqëson Av. I.D., nga Glllogovci, Komuna e Dreanasit, rr.” nr....., kundër të paditurve B.K., , S.K., nga fshatikomuna e Prizrenit të cilët me autorizim i përfaqëson av. E.R., nga Prizreni, Xh.K. I.K., Xh.K., Xh.K., A.K., F.K., dhe R.K., që të gjithë nga fshati, komuna e Prizrenit, me objekt kontesti revokim i kontratës mbi dhurimin, me datën 10.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

Procedura në këtë çështje juridike kontestimore **NDËRPRITET**, për shkak të vdekjes së të paditurve: Xh.K., dhe A.K., që të dy ish nga Petrova, komuna e Prizrenit.

Procedura e ndërprerë eventualisht do të vazhdoj kur trashëgimtarët e të paditurve të marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret Gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësit N.K., F.K., dhe Z.K., nga Prizreni, nëpërmjet të autorizuarës së tij, pranë kësaj gjykate ka iniciuar padi me objekt kontesti revokim i kontratës mbi dhurimin, kundër të B.K., , S.K., nga fshatikomuna e Prizrenit të cilët me autorizim i përfaqëson av. E.R., nga Prizreni, Xh.K. I.K., Xh.K., Xh.K., A.K., F.K., dhe R.K., komuna e Prizrenit.

Pas inicimit të padisë , gjykata iu kishte dërguar të paditurve aktvendimin me numër C.nr.442/19 të datës 27.07.2022,përmes të cilës i kishte ftuar palët që të japin përgjigjen e tyre për padinë e paditëses. Për palën e paditur përmes fletëdërgesës për dorëzim personal del konstatimi se të paditurit Xh.K., dhe A.K., kishin ndërruar jetë.

Për të vërtetuar një fakt të cekur si më lart gjykata përmes aktit të datës 29.07.2022, nga Zyra e Gjendjes civile në Prizren, kishte kërkuar gjendjen në librat e regjistrimit civil për të paditurit Xh.K., dhe A.K., përmes përgjigjes së saj të data 02.08.2022, paranuor në gjykatë më

datën 09.08.2022 gjykatës i kishte dërguar edhe certifikatën e vdekjes në emër të të paditurve Xh.K., dhe A.K.,.

Në bazë të certifikatës së vdekjes të lëshuar më datë 01.08.2022, nga Komuna e Prizrenit, me numër rendor dhe numrin e referencës 20/2019RV/20001 është vërtetuar se i padituri Xh.K., , kishte ndërruar jetë me datën 12.11.2019 në Petrovë, ndërsa në bazë të certifikatës së vdekjes të lëshuar më datë 01.08.2022, nga Komuna e Prizrenit, me numër rendor dhe numrin e referencës 20/2019RV/20001/Sp është vërtetuar se i padituri A.K., , kishte ndërruar jetë me datën 11.03.2019 në Cham, andaj kjo çështje juridike kontestimore **NDËRPRITET**, për shkak të vdekjes të paditurve të lartcekur.

Andaj, duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 277 pika (a) lidhur me neni 18 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim e Ligjit Nr. 03/L-006 e Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe neni 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMLORE NË PRIZREN

**Departamenti i përgjithshëm
C.nr.442/19, datë 10.08.2022**

**Gjyqtari
Taulant Rexhëbeqaj**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.